



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:257213
Datë: 22.12.2023
Numri i dokumentit: 05111120

C-IV-16- 0318

Paditësi: H S nga fshati K , Komuna Ferizaj .

Kundër

Të paditurës: Ndërmarrja Shoqërore KB „ Komogllava ” Prizren e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “ Driton Hoxha ” nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me dt. 21 dhjetor 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa, **NDRYSHOHET** Vendimi i AKP-së – Autoritetit të Likuidimit GJI 135- 0014, dt. 08 qershor 2016, dhe detyrohet e paditura KB „ Komogllava ” , që paditësit për periudhën Qershor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013 , t’ ia paguaj pagat e pa paguara në shumën 3,287.00€, sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034
- II. **Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 08 korrik 2016, pranë DHPGJS, është parashtruar padia / ankesa e paditësit kundër të paditurit në lidhje pagat e pa paguara për periudhën qershor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013, e cila është refuzuar me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) për NSH KB „ Komogllava ” GJI 135- 0014, më dt. 08 qershor 2016.

Paditësi ka theksuar, te i padituri është punësuar nga viti 1991, e gjerë në dhjetor të vitit 2013, kur është pushuar nga puna me pagesë , në vendin e punës si rojtar .

Paditësi te AKP-ja, ka parashtruar kërkesë kreditore , por Autoriteti i Likuidimit i ka refuzuar kërkesat .

Paditësi ka theksuar se pas përfundimit të luftës në Kosovë ka filluar të punoj në KB „ Komogllava ” edhe pse në kushte të vështira, këtë punë e ka kryer në depo alternative , pasi që në selinë e tyre ishte vendosur KFOR-i , dhe e gjithë veprimtaria e punës është bërë në harmoni

me ligjin dhe të gjithë punëtorët kanë pasur kontrata pune , sikundër edhe KB ka qenë e regjistruar si organizatë beznisore .

Meqenëse paditësi për punën dhe angazhimin e tij ka kontribuar në shtimin e kapitalit në Kooperativë, gjithashtu ka punuar me kontratë pune deri në dhjetor të vitit 2013, kurse asnjëherë deri më dt. 01.04.2014, nuk ka pasur asnjë vendim mbi ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Ka theksuar se të gjitha dokumentet i ka dorëzuar te e paditura, përkundër kësaj e njëjta e ka refuzuar kërkesën tonë .

Ka kërkuar të aprovohet kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën qershor të vitit 2012, deri në dhjetor të vitit 2013.

Padisë/ankesës ja ka bashkangjitur provat :

- Kopjen e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI 135- 0015, dt. 08.06.2016,
- Kopjen e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI 135- 0014, dt. 08.06.2016
- Parashtrësën e dorëzuar në AKP , Zyra në Gjilan , dt. 17.05.2016,
- Kopjen e Vendimit të KB „ Komogllava ”, dt. 04.01.2010, i nënshkruar nga drejtori S M,
- Kopja e dokumentit të dorëzuar në AKP , dt. 11.05.2016,
- Kopjen e Vendimit për pushimin pa pagesë , dt. 03.01.2014, i nënshkruar nga Drejtori S M,
- Kopjen e Vërtetimit të lëshuar nga KB „ Komogllava ”, dt. 13.01.2014, të nënshkruar nga drejtori S M ,
- Kopjen e dokumentit Deklarata e dorëzuar në AKP, dt. 10.05.2016, e nënshkruar nga tete persona ,
- Kopjen e deklaratës e dorëzuar në AKP, e pa nënshkruar,
- Kopjen e Librezës së punës për paditësin nr. 184513, e lëshuar nga komuna e Ferizaj,
- Kopjen e Aktvendimit për pushimin vjetor për vitin 2001,
- Kopjen e kontratës së punës dt. 28.07.2000,
- Kopjen e Çertifikatës së regjistrimit të KB „Komogllava ” me nr. 80148020 dhe dokumentacioni i konfirmimit , dt. 28.07.2000,
- Kopjet e kërkesave kreditore dhe atë për gjashtë paga , dt. 29.04.2014 dhe kopje e kërkesës për pagat e pa paguara për muajin qershor .2012 deri dhjetor 2013, në shumën 3,287.00€ . , dt. 29.04.2014

Më dt. 29.08.2016, AKP-ja, AL përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje , ndaj padisë/ ankesës së paditësit në lidhje me pagat e pa paguara për periudhën qershor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013, në shumën 3,287.00€, Vendimin e AL GJI135-0014 dhe GJI135- 0015 me propozim që kërkesa të refuzohet .

Në parashtrësë është deklaruar se NSH Komogllava është në procedurë të likuidimit nga data 10.03.2014, ndërsa paditësi ka ushtruar kërkesë kreditore për paga të pa paguara në shumën 3,287.00€, për periudhën qershor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013, sikundër edhe kërkesë për dëmshpërblim në shumën 1,038.00€, për ndërprerjeje të parakohshme të marrëdhënies së punës.

Ka theksuar se meqenëse dokumentacioni i paraqitur me kërkesë kreditore ka qenë i pa mjaftueshëm për pranim , AL më dt. 27.04.2016, i ka kërkuar parashtruesit të kërkesës informacione shtesë .

Parashtruesi i kërkesë është përgjigjur por nuk ka vepruar në dorëzimin e dokumentacionit.

AL ka konstatuar se dokumentacioni nga Parashtruesi është i pa mjaftueshëm për pranimin e pretendimeve të tija, pastaj nuk ka provuar se kishte marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe se ka ofruar shërbime pune gjatë periudhës së pretenduar , NSH nuk ka qenë një subjekt aktiv tregtar pranë ATK-së, gjatë periudhës së pretenduar dhe se sipas nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 , është refuzuar kërkesa.

Ka bashkangjitur :

- Kërkesën dt. 27.04.2016,
- Parashtrësën e paditësit 17.05.2016, për AKP-në,
- Kopjen e Librezës së punës,
- Vërtetimin dt. 13.01.2014,
- Vendimin dt. 04.01.2010,
- Vendimin për pushim pa pagesë dt. 03.01.2014,
- Deklarata e punëtorëve, dt. 10.05.2016,
- Formularin e kërkesë kreditore dt. 10.04.2014,
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit dt. 28.07.2000,
- Aktvendimin për lejimin e pushimit vjetor ,
- Kopjen e dokumentit identifikues
- Vendimin për themelimin e marrëdhënies së punës .

Më dt. 02.09.2016, paditësit ju është dorëzuar parashtrësja e mbrojtjes , por i njëjti nuk është përgjigjur.

Më dt. 27.02.2018, DHPGJS ka lëshuar Urdhër për paditësin për plotësimin e provave, por dorëzimi ka dështuar pasi është konstatuar më dt. 02.03.2018, nga dorëzuesi i postes se marrësi është shpërngul.

Më dt. 22.05.2023, paditësi ka dorëzuar parashtrësën me të cilën është deklaruar se provat janë dorëzuar në origjinal me padi, kurse njoftimin për ndërprerje të punës nuk kemi pranuar asnjëherë.

Nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Më dt. 23.05.2023, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër për paditësin pasi parashtrësja e më dt. 22.05.2023, nuk ishte e hartuar sipas nenit 35 të Ligjit nr. 06/L-086.

Më dt. 07.06.2023, paditësi ka dorëzuar parashtrësën e cila po ashtu nuk ishte e hartuar sipas nenit 35 të Ligjit nr. 06/L-086, përkundër faktit se e kishte hartuar te avokati MA SC Z B, mirëpo me të njëjtën ka precizuar kërkesën vetëm sa i përket pagave të pa paguara për periudhën 01.06.2012 deri më dt. 31.12.2013, në shumën 3,287€.

Arsyetimi Ligjor

Padia / ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet në padi /ankesë dhe parashtrësja si dhe provat e bashkangjitura nga paditësi dhe në përgjigje në mbrojtje, dhe pretendimet e të paditurit në parashtrësja si dhe provat e bashkangjitura.

Gjykata konstaton se në bazë të provave që paditësi kishte dorëzuar është vërtetuar fakti se paditësit kishte pasur të themeluar marrëdhënien e punës, në KB „ Komogllava ” në vendin e punës rojtar , dhe ky fakt është vërtetuar me kontratën e punës të lëshuar më dt. 01.08.2000, sikundër edhe me provën e dokumentit vërtetim, i cili dokument është dorëzuar në Gjykatë edhe nga e paditura me parashtrësë dt.29.08.2016 , të cilin vërtetim të dt. 13 janar 2014,e ka nënshkruar drejtori S M . Me këtë vërtetim pohohet fakti se H S i lindur më dt. 27.05.1956, është punëtor i KB „ Komogllava ” në vendin e punës si rojtar dhe të njëjtit nuk ju janë paguar pagat

për muajin qershor të vitit 2012, deri në dhjetor të vitit 2013. Po ashtu sipas këtij dokumenti vërtetohet se punëtori ka qenë rregullisht në punë dhe pagesa nuk ju është bërë për mungesë të mjeteve materiale . Vërtetimi lëshohet për të dëshmuar pran AKP_së, borxhi që ka KB Komogllava , ndaj punëtorit.

Se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune, ky fakt vërtetohet edhe me Librezë të punës, sikundër edhe me dëshminë që vetë e paditura, e ka dorëzuar me parashtresë të dt. 08.03.2021 ku në mesin e tete punëtorëv, e në listë e punëtorëve gjendet edhe paditësi me numrin rendor 6.

Gjykata në lidhje me lartësinë e pagës në shumën 173 €, këtë fakt e ka vërtetuar në bazë të dokumentit të kopjes së Vendimit dt. 04.01.2010, të cilin vendim e ka nënshkruar drejtori S M. Sipas këtij vendimi të gjithë të punësuarit nga muaji janar i vitit 2010, paga është nivelizuar në shumën 173 € .

Gjykata në bazë të listës së pagave të pa paguara e cila listë ju është dorëzuar AKP-së, Zyrës në Gjilan kjo rrethanë vërtetohet se dorëzimi i listës është bërë, më dt. 02.02.2016, e protokolluar me nr. 5493/16, dhe e njëjta është dorëzuar nga punëtorët J R dhe F A.

Gjykata me provën e dokumentit informata shtesë , drejtuar AKP-së, Zyra në Gjilan të cilën e ka pranuar më dt. 17.05.2016, me nr. protokollit 5712/16, nga paditësi, AL ju janë dorëzuar, provat sipas kësaj parashtrëse. Dorëzimi i provave ishte bërë në bazë të kërkesës së AKP-së , dt. 27.04.2016.

Gjykatës nga e paditura NSH dhe AKP-ja si përgjegjëse për administrimin e NSH-ve, nuk ka pranuar asnjë provë / dëshmi me të cilën do të vënin në dyshim vlefshmërinë e provave të dorëzuara nga paditësi, gjithnjë sipas parimit të barrës së provës, në kuptim të nenit 31.5 të Ligjit nr. 06/L086.

Gjykata pasi vërtetoi një gjendje të tillë faktike, kjo gjendje faktike ndryshon me gjendjen faktike të konstatuar në Vendimin e Autoritetit të Likuidit GJ135-0014, dt. 08.06.2016, sipas të cilit Vendim konstatohet, paditësi nuk ka dëshmi që vërteton një marrëdhënie aktive pune dhe të vlefshme me NSH –në, dhe aq më pakë se ka ofruar shërbime konkrete për NSH –në dhe si rrethoj e kësaj Autoriteti i Likuidimit ka vlerësuar se kërkesa ka mbetur jo e plotë edhe pas kërkesës për informata shtesë. Këtë vërtetim të gjendjes faktike Autoriteti i Likuidimit e ka konstatuar në Vendimin refuzues, pavarësisht nga fakti se paditësi, te Autoriteti i Likuidimit kishte dorëzuar si prova kontratën e punës, pastaj vërtetimin e lëshuar nga drejtori i KB „ Komogllava ”, listën e pagave të pa paguara , sikundër edhe vendimin mbi lartësinë e pagës së nivelizuar, në shumën 173 €.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se Vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI 135-0014, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit, në të cilin kërkohet kompensimi për pagat e pa paguara për periudhën qershor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013, në shumën 3,287.00€, si e pa vlefshme është për shkak se Autoriteti i Likuidit nuk e ka bërë vlerësimin e provave të cilat i ka pasur në disponim, në lidhje me vërtetimin e fakteve, dhe në këtë mënyrë nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, përkundër faktit se në shkresa të lendes, ka pasur kontratën e punës së paditësit me të cilin ai ishte caktuar në vendin e punës si rojtar , sikundër që ka pasur prova në lidhje me periudhën dhe lartësinë e pagave të pa paguara e të cilat sipas Vërtetimit të lëshuar nga drejtori S M , pagat nuk janë paguar punëtorve për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Kështu që si rezultat i mos vërtetimit të plotë të gjendjes faktike kemi edhe zbatim

të gabuar të drejtës materiale nga ana e Autoritetit të Likuidimit, që është zbatuar gabimish, dispozita e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 .

Si ligj në fuqi që rregullon çështjen e punës për periudhën kontestuese, është Ligji i punës i Republikës së Kosovës nr. 03/L-212, me nenin 55 të Ligjit në fjalë është rregulltar , paga kështu sipas nenit 55.1 parashihet ,, 1. I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ” .

Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1. pika 1.7 e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, rregullon ,, kërkesat e pasiguruara , përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritetet më të larta ”.

Në rastin konkret KB ,, Komogllava ” çështjen e pagave të punëtorëve e ka rregulluar me Vendimin e saj dt. 04.11.2010 , sipas të cilit të gjithë të punësuarve ju është caktuar paga në shumën 173€ ,ashtu që për periudhën qershor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013, shuma e pagave të pa paguara ka arritur për pagesë 3,287.00€, e cila shumë nuk është kundërshtuar për nga lartësia nga e paditura.

Gjykata, meqenëse ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që ka konstatuar Autoriteti i Likuidimit, sipas të cilës është vërtetuar me prova ekzistimi i marrëdhënies së punës, pastaj paditësi ka qenë në listën e pagave të pa paguara për periudhën kontestuese, sikundër që paga ka qenë e nivelizuar në shumën mujore 173€, e ka pranuar padinë/ ankesën e paditësit si të bazuar dhe u vendos që Vendimi i AL GJI 135- 0014 , të ndryshohet, ashtu që kërkesa e paditësit të pranohet dhe të detyrohet KB ,, Komogllava ” që paditësit për periudhën qershor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013, të paguaj pagat e pa paguara në shumën 3, 287.00€.

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar